

FJALË PËRSHËNDETËSE

*Arben Malaj**

I nderuar zoti Zëvendëskryeministër!

I nderuar zoti Guvernator!

Zonja dhe zotërinj!

Të nderuar pjesëmarrës!

Konferenca V Ndërkombëtare “Banka Qendrore në Kohën e Integritit”, të cilën më jepet rasti të përshëndes sot, është një moment i rëndësishëm për të vlerësuar jo vetëm rezultatet, por edhe sfidat e reja të së ardhmes që qëndrojnë në rrugën e zhvillimit dhe të konsolidimit të shoqërisë shqiptare.

Procesi i integritit të vendit është sot jo thjesht një ambicie për të gjithë, por një detyrim për të gjithë faktorët dhe institucionet e vendit, ku pa dyshim banka qendrore ka një mision të rëndësishëm.

Njëkohësisht, dëshiroj të vlerësoj se procesi i integritit nuk është një kalendar datash konkret por një tërësi standardesh dhe performance, të cilat realisht përcaktojnë efektshmërinë dhe përfitueshmërinë e ambicieve afatgjata.

Jo rastësisht, ditët e fundit në të gjitha ambientet politike të Bashkimit Evropian janë prezent debatet për Paktin e Stabilitetit dhe të Rritjes, ku shpresoj gjenden të harmonizuara politikat fiskale

dhe monetare, të cilat duhet t'i sigurojnë kontinentit tonë rritje ekonomike e punësim.

Krijimi i kuadrit ligjor bashkëkohor, ngritja e institucioneve në funksion të kuadrit ligjor modern dhe për më tepër, performanca dhe eficientia e tyre në procesin e integritimit do të jenë pjesë e sfidës sonë të përbashkët dhe afatgjatë.

Zhvillimi i kësaj konference më jep mundësinë që të ndalem pak në filozofinë e përgjithshme, nën të cilën është bërë e mundur një arritje e tillë dhe në rolin e Bankës Qendrore dhe të Ministrisë së Financave, si partnerë gjatë gjithë këtij procesi.

Stabiliteti makroekonomik i fazës pastranzicion në Shqipëri është tashmë një fakt i njohur që njihet si një sukses, si nga autoritetet ekonomike të vendit, po ashtu dhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Ritmet e larta të rritjes së PBB-së 6 -7 për qind përgjatë 13 viteve të fundit, niveli i kontrolluar i inflacionit 2 - 4 për qind, ulja graduale e deficitit nga 15 për qind në 4.5 për qind, ulja e borxhit publik në rreth 54 për qind të PBB-së, nivelet e qëndrueshme të këmbimit të monedhës kombëtare, Lekut, janë fakte që vazhdimisht sillen për të konfirmuar reformat e përbashkëta në funksion të stabilitetit makroekonomik.

Duke i vlerësuar njëkohësisht si mbështetje për pavarësi reale të Bankës së Shqipërisë, në këtë kontekst dëshiroj të theksoj që, në themel të këtyre sukseseve qëndron përpjekja për të harmonizuar politikën monetare dhe ato të konsolidimit fiskal, gjë që është bërë e mundur në bashkëpunimin e Ministrisë së Financave dhe Bankës Qendrore. Ky bashkëpunim, tërësisht institucional, ka rezultuar efektiv.

Arsyetimi pas këtij bashkëpunimi ka të bëjë:

1. Së pari me faktin që harmonizimi politikë fiskale – politikë monetare ka mundësi të konsiderueshme për të arritur maksimumin e përfitimeve të mundshme. Çfarëdo teorie ekonomie që t'i referohemi:

neoklasicizmit, kejnsonianizmit, monetarizmit, ekonomiksit të ofertës apo ekonomiksit të “Pritjeve Racionale”, besoj se argumentet pro harmonizimit të politikave fiskale me politikat monetare dhe si rrjedhim, pro partneritetit dhe bashkëpunimit të Ministrisë së Financave dhe Bankës Qendrore, janë dhe mbeten relevante. Besoj se, kjo konferencë do të jetë një rast më tepër për të nxjerrë në pah momentet më të rëndësishme në sfidat e integritimit.

2. Së dyti, vëmendja ndaj rolit të bankës qendrore në fushën e financave motivohet edhe nga roli thelbësor që ka ajo si garantuese e mirëfunksionimit të sistemit financiar. Pjesë e këtij sistemi është dhe rrjeti i ndërmjetësve financiarë. Këtu, unë do të përmendja arritjen më të madhe të këtij harku kohor që lëmë pas: krijimin, zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit bankar të strukturuar në banka të nivelit të parë dhe të dytë dhe në shoqëri sigurimesh.

Rritja e kursimeve, eficienta e angazhimit të kursimeve drejt investimeve në ekonominë tonë, natyrshëm janë të kushtëzuara edhe nga krijimi dhe nxitja e një sistemi modern të ndërmjetësve financiarë, ku natyrshëm vendin kryesor e zënë bankat.

Për stadin në të cilin ndodhet ekonomia e vendit tonë, jemi të qartë që ka një korrelacion të drejtpërdrejtë midis reformave të sistemit financiar, qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike dhe procesit të integritimit.

Besoj se, kjo konferencë është një moment mëse i përshtatshëm për të përmendur fazën e re në të cilën ka hyrë tashmë Shqipëria: rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Gjithnjë e më tepër, në diskutimin akademik po zë vend koncepti i cilësisë së rritjes, në raport me thjeshtë ritmet e rritjes. Po dalin prioritare dhe imponuese politikat që rrisin aftësinë konkurruese të ekonomisë.

Strategjitë e suksesit që bazohen në tregje që zgjerohen dhe integrohen po bëhen gjithnjë e më imponuese në një ambient ekonomik ku integrimi dhe globalizimi tashmë janë një realitet mbisundues, ndaj të cilit reagohe vetëm pozitivisht, duke rritur

eficiencën e politikave që njohin kostot, që harmonizojnë më mirë kostot me përfitimet.

Në këtë kontekst do të doja të artikuloja dhe disa nga sfidat për të cilat fola më lart dhe mendoj që duhet të përballojmë në të ardhmen. Ato kanë të bëjnë pikë së pari, me rritjen e investimeve në sektorët që e kanë mundësinë për të gjeneruar rritje të qëndrueshme ekonomike afatgjatë.

Si parakusht pra, janë përdorimi i strategjive efektive që i kushtojnë rëndësi jo vetëm boshtit kursim-investime, por edhe boshtit kredi-investime për të arritur ata objektiva, që tashmë janë sanksionuar në “Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social”.

Shqipërisë do t’i duhet jo vetëm të konkurrojë në tregje globale burimesh, por edhe të rrisë mundësinë dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve të veta.

Në këtë kontekst, politikat e interesave bankarë të zbatuar nga Banka Qendrore janë vendimtare, jo vetëm në aspektin makroekonomik si ndihmuese të balancave investim-kursime apo investim-gjendje likuiditeti, por edhe në funksionimin e sistemit të kredive për të nxitur nivelin e investimeve si afatshkurtra ashtu dhe afatgjata për sipërmarrje ekonomike efektive.

Mendoj se, Ministria e Financave do të jetë interlokutori i natyrshëm dhe më i besueshëm i Bankës Qendrore për të siguruar suksesin e strategjive të mësipërme.

Sfida, me të cilën Shqipëria do të përballë gjatë viteve në vazhdim, është sfida e integritit të ardhshëm në Bashkimin Evropian. Pa dyshim që, kjo sfidë, krahas aspekteve të tjera, nxjerr në pah dhe domosdoshmërinë e arritjeve financiare dhe makroekonomike që do të jepnin garancinë e nevojshme për suksesin e gjithë procesit, që ka filluar tashmë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Çështje të tilla si: rritja e efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave dhe e adoptimit të një filozofie të re në administrimin e shpenzimeve publike, në funksion edhe të kursimeve publike të iniciuar tashmë

nga Ministria e Financave, do të jenë natyrisht të lidhura me politikat e Bankës Qendrore, për të siguruar edhe në të ardhmen stabilitet të çmimeve dhe nivele interesash të pranueshme, në mënyrë që të arrihen nivele të qëndrueshme të konvertibilitetit të Lekut, të rritjes ekonomike dhe të punësimit në periudhë afatgjatë.

Duke përfunduar, desha të theksoj që “Banka Qendrore në Kohën e Integritimit” është një subjekt mëse i gjetur për shumë pyetje që kanë lindur nga nevoja për të përballuar sfidat e mësipërme. Debati shkencor për eksperiencat më të mira dhe shtrimi për diskutim së bashku i politikëbërësve me akademikët, krijon premisat e efektshmërisë maksimale të bashkëpunimit në këndvështrimin e sfidave të së ardhmes.

Duke qenë i bindur në suksesin e saj, do të doja t’iu shprehja vlerësim dhe mirënjohje të gjithë atyre që mundësuan këtë konferencë, zotit Kryeministër për praninë e tij si shenjë e rëndësisë që Qeveria aktuale i kushton mbarëvajtjes së saj dhe të gjithë pjesëmarrësve të saj, që pranuan të japin kontributin e tyre intelektual në këtë ndërmarrje.

Faleminderit!

* Arben Malaj: Ministër i Financave, Republika e Shqipërisë.

